



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V
Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor
Mbledhja nr. 18
Prishtinë, më 29.6.2015, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE MJEDIS E
PLANIFIKIM HAPËSINOR

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Emilija Redzeqi, Lahi Brahimaj, Haxhi Shala, Adem Salihaj, Shaip Muja, Salih Salihu, Murat Hoxha, Srdjan Popovic.

Munguan: Askush.

Të ftuar dhe pjesmarrës të tjerë: Sipas listës së nënshkrimeve.

Stafi mbështetës i komisionit: Ylber Sherifi, Dalina Kërqeli.

Mbledhjen e kryesoi Fikrim Damka, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbajtur më 23.06.2015,
3. Shqyrtimi i realizimit të planit të punës së komisionit, dhe formimi i grupeve punuese,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 23.6.2015

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i realizimit të planit të punës së komisionit, dhe formimi i grupeve punuese

Fikrim Damka – kryetar i komisionit, tha se javën e kaluar kemi shqyrtuar planin e punës për vitin 2015, ku për shkak të vonësive nga ana e qeverisë nuk i kemi përmblusur të gjitha aktivitetet të cilat i kemi paraparë më planin e punës së komisionit. Kemi rënë dakord që të dërgojmë një kërkesë qeverisë rreth ligjeve, por mora informatë që kryetari i kuvendit e ka dërguar për të gjitha komisionet, kështu që nuk kemi nevojë veqanarisht ne si komision të dërgojmë një letër shtesë për këtë çështje.

Poashtu javën e kaluar jemi dakorduar që të formojmë dy grupe punuese, një grup punues për mbikëqyrjen e Ligjit për Inspektionin Bujqësor, ligj të cilin e kemi paraparë me planin e punës dhe një grup punues për Projektligjin Për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit.

Grupi punues për mbikëqyrjen e Ligjit për Inspektionin Bujqësorë mori këtë përbërje: **Sali Salihu-kryesues, Lahi Brahimaj, Adem Salihaj dhe Haxhi Shala-anëtarë**, ndërsa grupi punues për Projektligjin për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit mori këtë përbërje: **Fikrim Damka-kryesues, Shaip Muja, Emilija Redzepi, Murat Hoxha dhe Srdjan Popovic-anëtarë**.

Murat Hoxha propozoi që në planin e punës së komisionit për gjashtë mujorin e dytë të parashihet edhe mbikëqyrja e Ligjit për Kadastrin.

4. Të ndryshme

Salih Salihu tha se tash është koha e vendimeve për grante e subvencione dhe po flitet nëpër qytetarë e fermerë se ka keqpërdorime. Ne si komision është mirë të përcjellim këtë punë, të shikojmë në aspektin statistikor se kah po shkojnë më shumë, a ka ndonjë ndikim politika, a po iu ipen fermerëve me të vërtetë, a po fitojnë gjithmonë të njëjtit, a ka dikush që e ka merituar si fermer por nuk iu është dhënë kështu me radhë. Mendoj se ka shumë mjete këtë vit, janë rreth 40 milion subvencione dhe është me interes ti përcjellim se kah po shkojnë.

Srdjan Popovic, shtoi se ka biseduar me disa fermerë të cilët ankohen se nuk e kanë linkun e ministrisë për të bashkëpunuar, gjithashtu aplikacionet nuk janë të përkthyer në serbisht, ndaj të gjitha kërkesat që i kanë i drejtojnë përmes komunës. Pyeti a mundet ky komision të organizoi një debat në këtë drejtim ku do të sqaroheshin gjërat deri në detaje, pasi që deri tani përfaqësuesit e pakicës serbe nuk kanë marr asnjë subvencion.

Lahi Brahimaj tha se atë që e tha Sali Salihu ka të bëjë më shumë me spekulime, por që nuk janë duke shkuar në adresa të drejta ka shumë raste, prandaj do të ishte mirë të merret dikush më këtë temë, ia vlen të shikohen sepse është çështje me interes.

Emilija Redzepi theksoi se problemi i subvencioneve për pakica është mjaft i madhë ndaj gjithnjë ka insistuar në zbutjen e kriterëve për bashkësitë e pakicave për shkak të diskriminimit

sa i përket konkurrimit, ajo potencoi edhe solucionin e formimit të fondit për pakica, me ç'rast ministri Krasniqi në një mbledhje me komisionin nuk është pajtuar, gjithashtu ajo ka biseduar me përfaqësuesit e USAID të cilët janë të gatshëm të financojnë grande, ndaj nëse formohet GP për subvencione ajo shprehu gatishmërinë për pjesëmarrje në atë GP. Ajo u pajtua me përfaqësuesin e pakicës serbe i cili tha se kjo pakicë në start nuk mund të konkurrojë për shkak të mospërmbushjes së kriterëve, (Lahi Brahimaj ndërhyri me pyetjen cilat kriterë), ajo u përgjigj dhe shtoi p.sh. tek krerët e lopëve nëse nuk i ka fermeri më tepër se 15 krerë nuk mund të konkurroi, ose për pemë e perime nëse nuk ka shumë hektarë të mbjellun për të konkurruar. Në fund ju drejtua kryetarit për angazhim të veçantë për shkak se edhe ai i takon pakicës turke.

Shaip Muja tha se, jam munduar edhe mandatin e kaluar ti adresoj disa probleme të cilat kanë qasje tjetër prej kësaj që tha edhe Salihu, se hipotetikisht ne kur po e themi fjalën publike nuk po e masim sa është e vlefshme dhe sa është e dëmshme.

Ne kemi një investim që është duke u shkatërruar në Lipjan e që është inkubatori për edukimin e fermerëve dhe unë propozoj që të gjejmë hapësirën ligjore që ai inkubatorë që është 25 apo 30ha i cili i ka modulet për edukim për fermerë, për blegtorët, për pemtari, për përpunimin e mishit, për përpunimin e djathit, qumështit dhe me i eduku fermerët. Problemi qëndron tek edukimi. Ne fatkeqësisht po japim grante te një pjesë ku autodidaktizmi po ndikon që produktiviteti nuk po ipet, dhe kur po ndahen grantet rezultati nuk po shihet sepse menaxhohet prej fermerëve të cilët nuk kanë edukim.

Sa i përket qështjes së minoriteteve kisha thënë që të mos politizohet por të identifikohet problemi. Qdo komunë e ka drejtorinë e bujqësisë, e cila është përgjegjëse për informimin e bujqëve dhe kur bëhet dizajnimi i një granti duhet të ndiqet protokolli. Propozoj që komisioni të bëjë një vizitë te inkubatori në Lipjan që është një investim i dështuar dhe me bë projekte intensive të edukimit në kohën kur fermerët nuk kanë punë. Prandaj propozoj që grupi ynë të bëjë një takim në inkubatorë në Lipjan me Ministrin e Bujqësisë, dhe ne si ligjvënës ta vëm në ligj qështjen e edukimit të fermerëve. Pa edukim te fermerëve kot japim grante.

Adem Salihaj tha se, kjo është një fushë e gjerë që kërkon shumë angazhim dhe unë jam i pajtimit që ne ta shohim se qka po ndodh por duhet ti kemi paraprakisht disa të dhëna konkrete nga ministria për vitin e kaluar sepse për këtë vit ndoshta ende nuk janë vendos, e nëse janë vendos i kërkojmë edhe për këtë vit. Mendoj që është mirë të kërkojmë listën e personave fizik dhe juridik që kanë konkurruar, që kanë marrë grante, listën e atyre që nuk kanë marrë të dim pse nuk kanë marrë, pastaj shumë e subvencionimit të secilit, të kërkojmë sipërfaqen me hektarë që subvencionohet për secilën kulturë bujqësore, të kemi një pasqyrë se qka po subvencionohet dhe numrin e krerëve që janë subvencionuar dhe kështu ne si komision të kemi një pasqyrë të politikave të qeverisë për qështjen e subvencioneve.

Sa i përket qështjes së pakicave pajtohem që të kërkojmë një informatë edhe për këtë, por unë mendoj se kriteret janë të njejëta për të gjithë, por nëse kanë një hendikep të caktuar dhe nuk mund ti përfitojnë grantet në asnjë mënyrë, atëherë ne mund ta diskutojmë këtë.

Salih Salihu tha se, grantet për këtë vit i kanë ndarë dhe kam dëgjuar se nëse dikujt i ka munguar një dokument i kanë pasur 5 (pesë) ditë afat për ti informuar dhe brenda 5 dite ata është dashur të sjellin dokumentacionin që ju mungon. Këta nuk e kanë informuar askënd nëse i mungon një dokument dhe vetëm ata që i kanë pas të rregullt dhe që iu kanë konvnuar i kanë pranuar ndërsa ata që nuk i kanë pas dokumentet nuk i kanë njoftuar.

Ka edhe vonesa të pagesave të vitit të kaluar të granteve dhe subvencioneve, shumë njerëz kanë dështuar me grante ku vitin e kaluar ju kanë ndarë por asnjëherë nuk i kanë marrë ato mjete. Subvencionet për misër dhe grurë ende nuk janë paguar.

Ndërsa sa i përket edukimit pajtoj plotësisht që ka mungesë të një praktike, përvoja moderne, por qështja e trajnimit të fermerëve është një problem shumë më i gjerë ku Ministria e Bujqësisë është duke hartuar një strategji 2015-2020 dhe secili institucion që lidhet me shërbimet kshëllimore është i obliguar me dërgu nga një individ. Por dilema është se kush duhet të certifikohet për të mbajtur trajnime psh nëpër komuna, kjo është një pikë ku kemi mbetë sepse ministria mendon që nuk ka nevojë të kyqet fakulteti, ndërsa unë mendoj që pa u kyq fakulteti nuk mund të kryhet kjo punë.

Lahi Brahimaj lidhur me aplikimet për grante dhe subvencione për minoritete tha se, në qdo komunë është drejtorja e bujqësisë e cila i ka në gjuhën e vet publikimet, psh nëse është në Graçanicë i ka edhe në shqip edhe në serbisht e nëse nuk i ka të publikuara në Web në komunë sigurisht i ka.

Sa i përket edukimit të fermerëve mendoj se është e kotë ti edukosh ata nëse së pari nuk caktohen kriteret për farën, plehin e për gjitha këto.

Haxhi Shala tha se ne jemi deputetë dhe nuk është mirë të themi diskriminim i një komuniteti se nuk ka diskriminim këtu, mund të jetë neglizhencë apo nuk është i përgaditur ai komunitet, prandaj fjala diskriminim të hiqet nga zhargoni sepse kemi 15 vite pas luftës dhe nuk ka diskriminim.

Besoj që një pjesë e madhe e subvencioneve dhe e granteve janë ndarë, ne është mirë të thërrasim ministrin dhe ai të na tregojë se si janë ndarë, të shohim se si i ka përpiluar ministria politikat e shpërndarjes së subvencioneve dhe granteve, të shohim edhe në mënyrë tabelare se si janë ndarë nëpër komuna dhe si bujqëve. E pastaj nëse ne dyshjome mund të krijojmë një komision hetimor pasi që si komision kemi të drejtë. E di që ka anashkalim të disa komnave, nuk është ndarë në mënyrë proporcionale qysh ndahet bugjeti.

Shaip Muja lidhur me propozimin e Adem Salihaj tha se egzistojnë struktura brenda Republikës së Kosovës të cilat duhet ti lëm të funksionojnë. Me atë metodë ne po dalim sikur nuk i besojm fare shtetit, kur nuk i beson shtetit i bie që nuk po implementohet ligji por ne po thirrmi në ligj, ku është shkelur ligji? Neve nuk na lejohet me ligj të shkojmë si deputetë për të hetuar dokumentacionin e agjencionit. Ne duhet të dim qka kemi të drejtë, ne duhet të thirrmi gjithmonë në ligj, ku detyrë e imja si ligjvënës që e kam aprovuar ligjin është të vërej se ku agjencioni, qeveria, auditimi, inspektorati nuk e kanë aplikuar ligjin.

Ne duhet të shkojmë të vizitojmë inkubatorin në Lipjan, protokollet dhe syllabuset ekzistojnë atje. I kemi dy të mira nëse shkojmë, një e mirë është për bujqit të cilët kanë për ta punuar tokën në Republikën e Kosovës dhe nëse arrijmë së bashku me z.Salih dhe të disa të tjerë tua bëjmë të barasvlefshëm edukimin bujqëve me një qertifikatë të pranueshme në tregun e Bashkimit European.

Srdjan Popoviq në kuadër të përpjekjeve pyeti a mund të bëhet ma mirë ngase sa i përket bujqësisë asgjë nuk veprohet, ndaj apeloj për një takim të përbashkët me të gjithë aktorët, komunat, Ministrinë e Bujqësisë etj dhe të dëgjohen ata për problemet dhe mekanizmat që duhet të ndërmarrën, dhe të shohim në fund sa mundet ky komision të ndihmoj në këtë drejtim.

Murat Hoxha tha se, jam i habitur sepse në kuvend kemi një numër të madh të raporteve por nuk kemi plane të punës dhe raporti pa plan të punës nuk ka kuptim. Ne kemi nevojë për strategji. Pajtohem me atë që tha Shaip Muja lidhur me inkubatorin e Lipjanit dhe mendojë që edukimi parandalon edhe abuzimin, në veçanti edukimi jo vetëm për fermerët por përfshirë edhe edukimin për hartimin e planeve të biznesit sepse fermeri nuk është në gjendje të hartojë një plan biznesi prandaj në strategjinë dhe në planifikimet e ministrisë duhet të parashihen edhe njerëzit që din të bëjnë plane biznesi. Ministria duhet të na ofrojë një strategji ku pjesë e asaj strategjie patjetër duhet të jetë edhe inkubatori ndërsa neve na takon të bëjmë monitorimin.

Adem Salihaj tha se, ne duhet të kemi kritere të njejëta për të gjitha qështjet, ose i hetojmë ose nuk i hetojmë, ose merremi ose nuk merremi. Nuk mund të themi se nuk mund ta kërkojmë listën e njerëzve që marrin subvencione e në anën tjetër të shkojmë të hulumtojmë a është ndotur uji apo a janë bërë mirë analizat etj. Të gjitha këto janë qështje të ekzekutivit. Janë gjëra të njejëta me ato që ka kërkuar z.Muja ti hulumtojmë, pra ose i bëjmë ose si bëjmë asnjë, ta kemi një parim të punës sonë, duhet të jemi parimorë. Ne jemi organ mbikqyrës i ekzekutivit ku detyrë e jona është të shohim se a e zbaton apo jo ligjin, prandaj edhe po merremi me të gjitha këto qështje. Përndryshe parimisht ne jemi persona politik-publikë, ne merremi me politikat.

Fikrim Damka- kryetar i komisionit tha se, mendojë që për qështjen e subvencioneve dhe granteve duhet të thërrasim ministrin e Bujqësisë. Prandajë propozojë që pas dy jave të thërrasim ministrin në komision për të gjitha këto qështje.

Shaip Muja tha se nuk duhet të lejojmë që agjencionet të vin këtu pa ministrin i cili është përgjegjësi-politikbërësi kryesorë, përveq atyre agjencioneve të cilat i kemi krijuar ne.

Fikrim Damka- kryetar i komisionit falënderoi deputetët dhe e mbylli mbledhjen.

PËRFUNDIM

U formuan dy grupe punuese :

Grupi punues për mbikëqyrjen e Ligjit për Inspektionin Bujqësorë në këtë përbërje: Sali Salihu-kryesues, Lahi Brahimaj, Adem Salihaj dhe Haxhi Shala–anëtarë.

Dhe grupi punues për Projektligjin për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit në këtë përbërje: Fikrim Damka-kryesues, Shaip Muja, Emilija Redzeqi, Murat Hoxha dhe Srdjan Popovic-anëtarë.

U vendos që në mbledhjen e radhës të ftohet Ministri i Bujqësisë për çështjen e subvencioneve dhe granteve.

Mbledhja përfundoi në ora 12:30

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,

Fikrim Damka